


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
REAL BAILIFF SERVICE SH.P.K

NIPT L71710039A

Nr.509 Regj
Nr.484/1Prot

Tiranë, më 12.02.2019

URDHËR
“PËR HEQJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”



Drejtuar: Qendra Kombetare e Biznesit
Adresa: Tirane
Per dijeni: “BRAJAN-AB” Sh.p.k, Nipt L58108503O (0689085666)
Adresa: Lezhe, Shenkoll, Gajush, Lagjja Qender, Rruga e Kampit,
Per dijeni: “MLI Emulsion” Sh.p.k, Nipt K74111401A
Adresa: Lgj. “Loni Dharmo”, Blv. “Instituti”, Lushnje,

Unë, Eris Sotiri, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Shoqërisë së Përmbarimit Privat “REAL BAILIFF SERVICE” Sh.p.k, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Vendimi Nr. 341, date 04.12.2018 i Gjykates se Rrethit Gjyqësor Lezhë, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore kërkesën e kreditorit “MLI Emulsion” Sh.p.k, Nipt K74111401A ndaj debitorit “BRAJAN-AB” Sh.p.k, Nipt L58108503O, në lidhje me titullin ekzekutiv “Fature tatimore e shitjes” Nr. 63, date 01.10.2016, me Nr. Serie 16668616.

Pas kryerjes se Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të detyrimit me shkresën Nr. 66 Prot, Datë 04.01.2019 dhe fillimit të ekzekutimit të detyrueshëm, referuar neneve 517 dhe 527 të K.Pr.Civile,

Me Shkresën Nr. 484 Prot, datë 29.01.2019 është dërguar Urdhër për Vendosjen e Sekuestros Konservative mbi aktivet e pales debitore, me qellim mostjetersimin tyre si dhe mos kryerjen çdo veprimi qe do te sillte ndryshime ne regjistrin tregetar.

Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet proceduriale të nevojshme për ekzekutimin e plotë të titullit ekzekutiv me palët e lartpërmendura,

KONSTATOVA:

Se pas verifikimeve të llogarive bankare rezulton se detyrimi është ekzekutuar teresisht.

Në këto kushte, referuar nenit 616 Pika (a) të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 32. Pikat (b,c) të Ligjit Nr. 10031, datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”,

URDHËROJ:

1. Heqjen e masës së Sekuestros Konservative, të vendosur me anë të shkresës Nr. 484 Prot, datë 29.01.2019, mbi aktivet e pales debitore “BRAJAN-AB” Sh.p.k, Nipt L58108503O, me qellim mostjetersimin tyre, si dhe mos kryerjen çdo veprimi qe do te sillte ndryshime ne regjistrin tregetar.
2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.
3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.

“REAL BAILIFF SERVICE” Sh.p.k
PËRMBARUESI GJYQËSOR
Eris SOTIRI

